

Dokument politikash: Masat për përmirësimin e IPR strukturës në Kosovë

**Punuar nga Bardh Shkreli- STIKK
2011**

Përmbajtja

Hyrje	3
IPR dhe ligji i konkurrencës në treg	Error! Bookmark not defined.
Procedurat e aplikimit për patentë në Kosovë	Error! Bookmark not defined.
Zyra e Pronësisë industriale (ZPI) (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë)	7
Zyra për të drejtën e autorit (Copyright Office), (Ministria e Kulturës)	10
Spektori për IPR në Doganat e Kosovës	11
Komisioni i pavarur për media (KPM)	13
Ministria e Bujqësisë –Produktet me indikacion gjeografik	14
Gjykatat	14
Policia (njësiti për krime ekonomike)	15
Spektori i ICT-së në Kosovë	17
Propozimet	Error! Bookmark not defined.
Krijimi i këshillit nacional kundër falsifikimit	21
ANEKS 1	Error! Bookmark not defined.


Hyrje


Ky dokument është iniciuar nga Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK) bazuar në nevojat e anëtarëve të kësaj shoqate shumë prej të cilëve krijojnë asete me vlerë intelektuale (softuerë, ueb dizajnë, know-how etj.) Nevoja për një dokument politikash për masat që duhet të ndërmerren në fushën e IPR në Kosovë janë identifikuar nga punëtorja e organizuar nga STIKK dhe USAID me titull “Intellectual Rights Workshop” I dhe II.

Studimi ka për qëllim prezantimin e strukturës ligjore, institucionet bartëse dhe akterët implementues të saj. Për më tepër, studimi mëton të identifikojë problemet e subjekteve të lartpërmendura dhe të propozojë masa që duhet të ndërmerren për një funksionim dhe implementim sa më të mirë të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale në Kosovë.

Mbrojtja e aseteve, krijimtarisë artistike dhe ngjashëm apo kategori tjera që konsiderohen si pronësi intelektuale (patentat, markat tregtare, të drejtat e autorit etj.) siguron një ambient të mirë për risitë dhe inovacionet në fusha të ndryshme të shkencave. Kjo është çështje kyçe kur bëhet fjalë për përparimin teknologjik, mbrojtjen e investimeve dhe konkurrencën në treg. Të drejtat e pronësisë intelektuale sigurojnë bazën ligjore për parandalimin e keqpërdorimit të kësaj prone. Kjo ndodh kur pala e tretë përdor të drejtën e pronës intelektuale pa lejen e mbajtësit të kësaj drejte. Mbrojtja e këtyre të drejtave është faktor themelor për zhvillimin e konkurrencës së rregullt dhe të drejtë në çdo aspekt të jetës

sociale dhe ekonomike të një vendi. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, në nenin 27 të saj specifikon se: “Gjithkush ka të drejtë të mbrojë interesat morale dhe materiale, që rrjedhin nga çdo krijimtari shkencore, letrare dhe artistike, autor i të cilave është ai vetë.” Kjo deklaratë është e mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 2). Kështu mbajtësi i këtyre të drejtave ka të drejtë nën kushte të caktuara të marrë masa kundrejt këtij përdorimi. (l. fq37). Në ekonomitë më të zhvilluara të botës (SHBA, EU, Japoni etj.) mbrojtja e pronësisë intelektuale luan rol shumë të rëndësishëm për vetë ekonomitë e tyre. Ekonomitë e bazuara në njohuri (knowledge based economies) janë ekonomitë e shoqërive të informacionit ku faktorët kyç janë teknologjitë e informacionit, rrjetet kompjuterike, media, inteligjenca kolektive etj. Rreth 70 % e punonjësve në këto lloje të ekonomisë janë punëtorë të teknologjisë së informacionit. Kosova, dhe në përgjithësi industria e saj e teknologjisë së informacionit (softuerike, harduerike, media etj) duhet të kenë ambient të përshtatshëm për tu zhvilluar, ndërsa faktori kryesor për këtë mbetet mbrojtja e të drejtave intelektuale. Se sa të rëndësishme janë kompanitë e që merren me teknologji të informacionit tregon raporti special i botuar nga Financial Times i datës 19 Maj 2011. Vlera e brendeve nga teknologjia e informacionit mbizotëron dukshëm ndaj brendeve të industrive tjera.





1

Përparimi teknologjik po i bashkon disa prej industrive më masive në ekonominë globale. Sipas Business Week, industria globale e kompjuterëve dhe softuerëve me vlerë prej 1.1 bilion \$, ajo e konsumit të pajisjeve elektronike me vlerë prej 225 miliardë \$ si dhe teknologjia e telekomunikimit me një pjesëmarrje prej 2.2 bilion \$, po ofrohen njëra me tjetrën si kurrë më parë. Kombinimi i çipeve gjithnjë e më të fuqishëm, tejkalimi i banduithëve, përmirësimi i flat TV-ve, dhe depërtimi marramendës i telefonave inteligjentë është duke na shpjerë në një ambient ku kompanitë të cilat tradicionalisht kanë qenë të njohura në një industri, po bëhen po aq të njohura në industritë tjera. Në gjithë këtë ndryshim, pronësia intelektuale luan një rol vendimtar për shkak se mundëson përparimin teknologjik duke i mbrojtur investimet që bëhen në Hulumtim dhe Zhvillim (R&D). Kompania DELL ka qenë një kompani e cila tradicionalisht ka shitur adapterë elektrik për kompjuterë por tanimë shet edhe GPS sisteme. Licencimi i teknologjive po e mundëson daljen e tyre në treg për një kohë më të shpejtë².

IPR dhe ligji i konkurrencës në treg

Konkurrenca e lirë në treg është e mbrojtur në Kosovë me Ligjin e Konkurrencës (2004/36). Ky ligj siguron ambient të favorshëm dhe të barabartë për konkurrencë në treg për të gjithë. Mungesa e zbatimit adekuat të ligjit të të drejtës intelektuale do të bënte që një biznes të

¹ Financial times-issue May 2011

² Mastering Intellectual Property Life Cycle, 2nd edition- pg. 28.

përfitonte nga prona legjitime e një subjekti tjetër dhe të dëmtonte kështu konkurrencën e drejtë. Pika 12.1 e këtij ligji i dedikohet pjesës së të drejtës intelektuale dhe pak a shumë përfshin të gjitha format e këtyre të drejtave.

Problemet lidhur me aderimin e Kosovës në organizata të rëndësishme për mbrojtjen e Drejtave të Pronësisë Intelektuale.

Kosova është në proces e sipër të ndërtimit të një strukture Evropiane të ligjeve, dhe në përgjithësi mbështetet tek marrëveshjet ndërkombëtare. Pjesë e angazhimit të institucioneve të Kosovës është edhe anëtarësimi i Kosovës në organizata apo marrëveshje ndërkombëtare, megjithatë vërehet një progres i vogël në fushën e IPR pasi që Kosova realisht nuk është anëtare e ndonjë organizate apo marrëveshjeje të rëndësishme (p.sh. WTO, WIPO, EPO etj.) Aderimi në organizata si World Intellectual Property Organization ka disa parakushte të cilat janë të postuara në uebsajtin zyrtar të WIPO-s tek “kriteret e pranimit”³, ndër to edhe anëtarësimi në Kombet e Bashkuara. Për këtë arsye aderimi në WIPO mbetet për më vonë, përderisa aderimi në Organizatën Botërore të Tregtisë (ËTO) është një proces i cili duhet shtyrë përpara ngaqë shtetësia e pranuar në Kombet e Bashkuara nuk është kusht për anëtarësimin në WTO. “Çdo shtet apo territor doganor mund të bëhet anëtar i WTO-së. Megjithatë, konsensusi duhet të arrihet në mes të gjithë vendeve anëtare.”⁴ Kjo nënkupton që negociata të shumta dhe lobim i posaçëm duhet zhvilluar për ti bindur vendet “problematike” të mos votojnë kundër. Por, meqenëse WTO nuk është organizatë e Kombeve të Bashkuara roli i saj nuk është politik dhe anëtarësia e një vendi nuk aludon në shtetësi të pranuar ndërkombëtarisht. Për këtë më se miri flet rasti i Tajvanit, i cili nuk është i pranuar në Kombet e Bashkuara por është anëtar i WTO-së.

Prandaj duhet bërë të pamundurën që Kosova edhe zyrtarisht të jetë nënshkruese e TRIPS-it (Trade Related Aspect of Intellectual Property Rights), që është njëra ndër marrëveshjet bazë të WTO-së, edhe pse Kosova e respekton atë “de jure”⁵. Aderimi në WTO është shumë i rëndësishëm për shkak se TRIPS ka vënë standardin minimum global për të drejtat e pronësisë intelektuale.

³ http://www.wipo.int/members/en/#admission_criteria

⁴ http://www.wto.org/english/thewto_e/acc_e/acc_e.htm

⁵ “Strategjia e Pronësisë Intelektuale 2010-2014”.

Procedurat e aplikimit për patentë në Kosovë

Procedurat për aplikim të patentës mund të gjenden në ueb faqen e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (<http://www.mti-ks.org/?cid=1,381,425>). Për patent mund të aplikojë vetë personi i cili qëndron pas patentit (shpikësi/ët ose personi i autorizuar).

Një gabim i vogël teknik mund të hasset tek aplikacioni zyrtar për regjistrimin e patentës, ku lihet e hapur mundësia për të mos cekur shpikësin në aplikacion. Kjo bie ndesh me nenin 12 të Ligjit për Patenta pika 12.3.

Ligji i patentës nuk i referohet fare çështjes së avokatëve apo përfaqësuesve ligjor të patentës. Në këtë ligj nuk është e caktuar se kush mund të jetë përfaqësues ligjor në procedurat ligjore në rast nevojë. Në shumicën e legjislacioneve të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian⁶ përfaqësuesit ligjor të patentave janë persona me arsim përkatës në fusha shkencore zakonisht në inxhinieri, kimi, fizikë etj. Lëndët gjyqësore që kanë të bëjnë me patenta kërkojnë gjyqtarë me po aq përgatitje akademike. Nuk mjafton përgatitja vetëm në fushën juridike për shkak se pretendimet e patentave janë aq komplekse sa që duhen njerëz me përgatitje specifike nga fusha të ndryshme shkencore që korrespondojnë me fushën për të cilën pretendon një patentë. Me fjalë tjera, është gati e pamundshme që p.sh. një gjyqtar me përgatitje shkencore të themi nga fusha e fizikës të vendosë për një patentë që ka të bëjë me fushën e biokimisë. Vendimi i tij mund të jetë i padrejtë si rezultat i injorancës profesionale që ka të bëjë me fushën përkatëse. Përgatitja e këtij kuadri mund të jetë një sfidë për shkak se kërkon përgatitje të lartë akademike që ndonjëherë mund të mungojë në vend.

Zyra e Pronësisë industriale (ZPI) (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë)

E themeluar në vitin 2007, kjo zyre është pikënisja e mbrojtës së të drejtës intelektuale. Edhe pse me ligj kjo zyrë ka një autonomi të vogël brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë së Republikës së Kosovës, roli i saj do të duhej të ishte esencial në organizimin

⁶ Ligji për patenta (France, Gjermani)

dhe monitorimin e implementimit të ligjeve të IPR. Megjithëse ZPI-ja ka siguruar të hyra të konsiderueshme për buxhetin e Kosovës (afër gjysmë milion Euro në vit), vetëm së fundi është mundësuar që 10% nga këto të ardhura të shkojnë në buxhetin e kësaj zyre.⁷ Zyra ka 9 punëtorë, 4 prej të cilëve janë nëpunës të rëndomtë pa ndonjë përgatitje profesionale në fushën e IT-së. Zyra është e udhëhequr nga drejtori i kësaj zyre i cili kryen disa funksione brenda zyrës, përfshirë këtu edhe anëtarin e komisionit të ekzaminimit të aplikacioneve për marka tregtare dhe patenta. Pjesa tjetër e shërbyesve brenda kësaj zyre nuk kanë ndonjë përgatitje akademike të posaçme në fushën e IPR-së megjithëse përvoja në punë dhe trajnimet e shumta kanë ndihmuar në ngritjen e tyre profesionale.

Kosova aspiron dhe punon në përgatitjen e strukturës ligjore dhe harmonizimin e ligjeve me ato të Bashkimit Evropian. Njëra ndër marrëveshjet që Kosova pritet të nënshkruaj në një të ardhme të afërme është edhe marrëveshja për Asocim -Stabilizim me Bashkimin Evropian. Një ndër kushtet që Kosova duhet të plotësojë është krijimi i strukturës ligjore për mbrojtjen e pronës intelektuale dhe implementimi rigoroz i saj. Të drejtat e pronësisë intelektuale kanë qenë të neglizhuara dhe shumë pak i është kushtuar rëndësi ngritjes së një strukture efektive të IPR në Kosovë. Kjo madje përmendet edhe në Raportin e Progresit të Bashkimit Evropian për Kosovën.

Bashkimi Evropian në përgjithësi, por edhe vendet anëtare në veçanti, janë të vendosura në mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe kjo bëhet me përkushtim. Ekzistojnë shumë arsye pse të drejtat e pronësisë intelektuale janë të rëndësishme dhe ndikojnë në spektër të gjerë fushash në çështje socio-ekonomike dhe politike të Bashkimit Evropian. Ndër to përmendim: mbrojtja e investimeve dhe iniciativës si dhe përparimi teknologjik në gati të gjitha sferat e shkencave ekzakte, mbrojtja e sektorëve të ndryshëm ekonomik (farmakologji, bioteknologji, teknologjia e informacionit, auto-moto industri, kinematografi, industri e muzikës, mbrojtja e drejtës së autorëve dhe veprave të tyre, mbrojtja e konsumatorëve, mbrojtja e brendeve dhe “Goodwill⁸” të kompanive, mbrojtja dhe sigurimi i të drejtave të barabarta të konkurrencës në treg, siguria e qytetarëve në Bashkimin Evropian, etj). Duke marrë parasysh këto fakte, Qeveria e Kosovës, por edhe ministritë përkatëse, dikasteret apo

⁷ Burim brenda MTI-së.

⁸ Goodwill nënkupton emrin e mirë apo famën që ka një kompani në treg e që konsiderohet aset i paprekshëm

departamentet e veçanta të cilat do të jenë grupe të interesit në implementimin dhe ngritjen e strukturave të IPR në Kosovë duhet të gëzojnë përkrahje qoftë financiare, logjistike e profesionale në ngritjen dhe implementimin me sukses të këtyre të drejtave.

Zyra për Pronësi Industriale (këtu e tutje të referohet si ZPI) ka nevojë për punëtorë të rinj dhe për ndërtimin e sektorëve të rinj brenda zyrës. Intensiteti i punës në këtë zyrë është enorm dhe i mbingarkuar. Zyra që nga viti 2007 deri në maj 2011 ka pranuar rreth 21 mijë aplikime⁹ (patenta e marka tregtare) vetëm 4500 prej tyre janë proceduar dhe janë shpallur në buletin zyrtar të ZPI-së.

Viti	Marka tregtare	Patenta	Dizajnë Industriale	Gjithsej
2007	87	1	1	89
2008	16200	1244	40	1784
2009	1533	294	8	1835
2010	1226	185	22	1433
Maj 2011	541	49	6	596
Gjithsej	19587	1773	77	21437

Me kapacitetin aktual që ka kjo zyrë puna e shqyrtimit të aplikacioneve tjera nuk do të mund të kryhet brenda vitit 2014 kur edhe është paraparë të aplikohet strategjia e pronësisë intelektuale 2010-2014. Kjo zyrë nuk ka një organogram të qartë dhe i mungon

⁹ MTI e Republikës së Kosovës

kapaciteti njerëzor në kryerjen e këtyre detyrave. Drejtuesit e kësaj zyre kanë kërkuar pandërprerë që zyra të pajiset me njerëz të rinj të fushave të ndryshme dhe të ketë një buxhet më të mirë. Hapësira në të cilën është e vendosur kjo zyrë nuk i plotëson kushtet për punë as për së afërmi. Të gjithë këta faktorë ndikojnë negativisht në kryerjen e detyrave të kësaj zyre.

Zyra për të Drejtën e Autorit (Copyright Office), Ministria e Kulturës

Takimi me z. Skënder Boshtrakaj ,udhëheqës i Zyrës për të Drejtat e Autorit, në Ministrinë e Kulturës, ka ndodhur gjatë procesit të ndryshimit të Ligjit të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta. Ligji nuk është amendamentuar thelbësisht por vetëm në disa pika të cilat kanë të bëjnë me përgjegjësitë e kësaj zyre. Do të ishte problematike nëse kjo zyre duhet të ofrojë një shërbim për regjistrimin e veprave të cilat do të paraqiteshin nga autorët apo përfaqësuesit e tyre. Shërbim i cili në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian nuk ofrohet megjithëse ekzistojnë edhe shtete ku ky shërbim ofrohet. Në vendet e Beneluksit ekziston një institucion i quajtur “IDepot” i cili ofron shërbim të regjistrimit të një ideje, koncepti apo procesi, i cili evidentohet me të dhënat e parashtruesit të kësaj kërkesë dhe datën e aplikimit. Më pastaj parashtruesit të kërkesës i lëshohet një certifikatë e cila dëshmon përmbajtjen e kërkesës, emrin dhe datën e parashtruesit. Por kjo nuk do të thotë që procesi, ideja apo koncepti i regjistruar cilësohet si pronë intelektuale, prandaj edhe rëndësia e saj nuk është e madhe në rast kontesti mbi autorin e vërtetë të një krijimtari (qoftë ajo, në rastin tonë, softuerike, dizajn apo diç e ngjashme). Përgjegjësia e zyrës është këshillëdhënëse dhe autorizuese e shoqatave që merren me menaxhim kolektiv. *(P.sh. shoqata e shkrimtarëve është e autorizuar të merret me mbrojtjen e të drejtës së shkrimtarëve, shoqata e kineastëve është e autorizuar të merret me të drejtat e kineastëve dhe veprave të tyre).* Në rastin tonë, Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK) do të mund të shërbente si përfaqësues i sektorit të IT-vë në këtë sferë, dhe sigurisht kjo do të mund të ndodhte kur edhe të fillojë certifikimi i shoqatave për menaxhim kolektiv. Problem tjetër që do të lindte me krijimin e një shërbimi të regjistrimit të drejtës së autorit është edhe forma me të cilën ajo do të ruhej. Meqenëse kjo

e drejtë zgjatë 70 vite pas vdekjes së autorit, e në raste tjera edhe deri 100 vite pas krijimit të saj, shtrohet pyetja në çfarë forme do të ruhej kjo e drejtë (CD, videokasetë, DVD, foto, apo forma tjera)? Shumica e medimeve të përmendura kanë një afat kohor të cilat nuk garantojnë ruajtjen me siguri të formës së plotë të veprës. Problem tjetër është edhe përparimi teknologjik i cili është i paparashikueshëm dhe përparon me hapa të shpejtë. Me këtë lind edhe problemi i ripërtrirjes së formës së ruajtur të një krijimtarie. Kjo do të kërkonte delikatesë dhe staf të trajnuar edhe në restaurim gjë që do ta komplikonte edhe më tej këtë shërbim. Prandaj, menaxhimi i drejtës së autorit brenda shoqatave për menaxhim kolektiv do të ishte më i lehtë dhe më praktik, dhe këto shoqata do të mund të zgjidhnin konteste të ndryshme brenda anëtarëve të tyre pa pasur nevojë t'u drejtohen gjykatave.

Përndryshe, Zyra për të Drejtat e Autorit është një zyrë e sapoformuar dhe ka dy punonjës. Kapacitetit i zyrës pritët të dyfishohet dhe të plotësohet me punonjës adekuat. Si e tillë, zyra ka nevojë për staf adekuat që ka njohuri nga fusha e IPR, por edhe trajnime të ndryshme mbi të drejtat e autorit dhe praktikën e tyre në vendet anëtare të BE-së. Vërehet edhe një izolim i Kosovës në pjesëmarrjen e forumeve apo konferencave që kanë të bëjnë me të drejtat e autorit por edhe të drejtave tjera intelektuale në përgjithësi.

Sektori për IPR në Doganat e Kosovës

Ky sektor është themeluar më 1 shkurt 2009 në kuadër të doganës së Kosovës dhe përbëhet nga një staf prej 4 personash. Shumica e të punësuarve nuk kanë edukim akademik në fushën e IPR por janë trajnuar nga një sërë trajnimesh në këtë fushë nga organizata e projekte të ndryshme si EUKTA, SNB-react, EUAPO etj. Sipas udhëheqëses së kësaj zyre Znj. Sadije Topjani, zyra ka nevojë të mëtutjeshme në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe në shtimin e trajnimeve në fushën e IPR. Sipas saj, mësimi nga përvojat e një vendi të anëtarësuar në BE si rasti i Sllovenisë do të ishte me leverdi dhe do të rezultonte në suksese edhe më të mëdha.

Ky sektor vepron në bazë të ligjit L-170/2010- Masat Doganore për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale, por zyrës i mungojnë ekspertët ligjorë të cilët do të sqaronin përmbajtjen dhe

kompetencat e këtij sektori në përgjithësi. Funkcionimi i këtij sektori është i varur nga Zyra për Pronësi industriale (ZPI) në Ministrinë e Tregtisë. Meqenëse zyra vepron në bazë së kërkesës së mbajtësit të së drejtës, shpesh këta të fundit nuk mund të sigurojnë vërtetim nga ZPI-ja se marka tregtare të cilën ata kërkojnë ta mbrojnë është e regjistruar në mënyrë valide pranë ZPI-së. Për shkak të aplikacioneve të markave tregtare të grumbulluara në ZPI, kjo e fundit e ka të vështirë procesin e regjistrimit të tyre për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm njerëzor, dhe si pasojë, sektori për IPR i Doganave të Kosovës nuk mund të veprojë me efikasitet apo në kohën e duhur. Në anën tjetër, numri i intervenimeve në konfiskimin dhe asgjësimin e mallit ka qenë disa herë më i madh se i vendeve të rajonit. Sipas të dhënave të kësaj zyre, numri i intervenimeve ka qenë 32 (30 prej tyre bazuar në kërkesën e mbajtësve të drejtës) dhe 2 intervenime ex-officio¹⁰. Që nga themelimi i kësaj zyre janë konfiskuar e asgjësuar mall me vlerë 790 mijë euro (bazuar në vlerën e mallit në treg) apo (230 000 njësi). Zyra është në proces të nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit me ZPI-në dhe Zyrën për të Drejtën e Autorit. Megjithëse vërehet vullnet dhe gatishmëri e madhe e punës, kjo zyrë i vuan pasojat e problemeve që ka ZPI-ja me mungesë fondesh, burime njerëzore e kapacitete të tjera të lartpërmendura. Një tjetër e metë në funksionimin e sektorit janë edhe databazat që sipas znj. Topjani nuk janë funksionale dhe janë të vështira për përdorim. Më poshtë janë disa foto të mallit të konfiskuar dhe të asgjësuar nga Doganat e Kosovës.



Me iniciativë të ZPI-së është duke u themeluar Këshilli Nacional për IPR, pjesë e të cilit do të jetë Sektori për IPR i Doganave të Kosovës.

Asgjësimi i mallrave kërkon kushte të caktuara dhe infrastruktura e paraparë për këtë çështje mungon. Në krijimin e një infrastrukture adekuate për asgjësimin e mallit te

¹⁰ Dogana e Kosoves

konfiskuar në emër të mbrojtjes së të drejtës intelektuale kërkohet një bashkëpunim me Ministrinë e Ambientit dhe Ministrinë e Bujqësisë, përkatësisht me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë. Kjo e fundit është prezent në pikat doganore të Republikës së Kosovës dhe bën kontrollin fito-sanitar të mallrave që hyjnë në territorin Republikës së Kosovës. Së paku një rast i konfirmuar nga Sektori i IPR në Doganat e Kosovës ka qenë bashkëpunim në mes të kësaj agjencie dhe këtij sektori. Malli i ndaluar ka rezultuar si i rrezikshëm për konsumatorët por të njëjtën kohë edhe i falsifikuar. Kësisoj, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në bashkëpunim me Sektorin kanë bashkëpunuar në asgjësimin e këtij malli. Përndryshe, ndërtimi i kësaj infrastrukture për asgjësimin e mallrave të konfiskuara nga Sektori, apo mallrave të rrezikshme do të ishte në shërbim të dy institucioneve.

Komisioni i pavarur për media (KPM)

Është një institucion i cili merret me licencimin e frekuencave transmetuese për territorin e Kosovës si dhe me kontestin audio vizual që këto medime transmetojnë. Komisioni bën edhe monitorimin e mediave si dhe “disiplinimin” e transmetuesve. Për shkak të përmbajtjes që kanë programet TV apo radio, ky komision domosdo ndeshet me të Drejtën e Autorit e cila në shumë raste është shkelur dhe neglizhuar. Sipas znj. Naile Selimaj, shefe ekzekutive e Komisionit të Pavarur për Media, komisioni ka pranuar ankesa lidhur me shkeljen e të drejtave të Autorit apo atyre të përfaqësuara, të cilat në të shumtën e rasteve janë menaxhuar nga komisioni në bazë të një rregulloreje të hartuar nga vet Komisioni (e miratuar në vitin 2009). Komisioni ka qenë konstruktiv në dhënien e komenteve lidhur me amendamentimin e ligjit të Drejtave të Autorit. Ky komision, edhe pse është i lidhur drejtpërdrejt me zbatimin e të drejtës së Autorit, nuk është i përfshirë në ligjin e të drejtave të autorit por as në strategjinë e IPR 2010-2014. Si rrjedhojë, mbetet i paqartë roli i këtij komisioni në këtë fushë. KPM-ja ka marrë vendime lidhur me shkeljen e të drejtës së autorit në rastet ex-officio, përderisa në rastet e dërguara në gjykatë, KPM-ja ka dhënë kontributin e vet këshillëdhënës me ftesë të gjykatës. Përkundër paqartësisë ligjore dhe rolit të pa definuar që ka ky institucion lidhur me zbatimin e të drejtës së autorit dhe drejtave tjera të

përafërta, KPM-ja ka nevojë për krijimin e një departamenti të veçantë i cili do të merrej posaçërisht me shkeljet e këtyre të drejtave brenda spektrit që menaxhon.

Ministria e Bujqësisë –Produktet me indikacion gjeografik

Shumë vende mbrojtjen e indikatorëve gjeografik e kanë të përfshirë në ligjin për Marka Tregtare (SHBA, Japonia, Australia etj.). Sidoqoftë, vendet e Bashkimit Evropian kërkojnë legjislacion të veçantë (sui generis) për mbrojtjen e indikatorëve gjeografik. Prandaj, si pikënisje për hartimin e ligjit mbi indikatorët gjeografik duhet të shërbejë Marrëveshja e Lisbonës e cila u jep tretman të veçantë produkteve që mbajnë këtë markë. Sipas disa zyrtarëve brenda Ministrisë së Bujqësisë Ligji për Indikatorët Gjeografikë është duke u përgatitur. Në hartimin e këtij ligji duhet pasur kujdes që ai të jetë në përputhshmëri me legjislacionin e Bashkimit Evropian, më saktësisht Direktivat e Bashkimit Evropian 2081/92 dhe 2082/92 si dhe marrëveshjen TRIPS (sidomos Neni 22).

Gjykatat

Funksionimi dhe kompetencat e gjykatave si dhe llojet e tyre janë të rregulluara me ligjin Nr.03/L-99. Gjykimet mbi çështje që kanë të bëjnë me pronësinë intelektuale nuk janë të specifikuar me ligj, siç kanë qenë me ligjin e vjetër të KSA e Kosovës të vitit 1978 mbi Gjykatat e Kosovës 20/77. Pasi çështjet e IPR më së shumti korenspondojnë me çështjet ekonomike, gjykatat përgjegjëse për këtë fushë janë të shpjeguara si në vijim.

Gjykatat në Kosovë janë organizuar në:

- ❖ Gjykata e shkallës së parë ose gjykata themelore;
- ❖ Gjykata e shkallës së dytë ose gjykata e apelit;
- ❖ Gjykata supreme.


Neni 11 specifikon edhe juridiksionin e gjykatës themelore i cili në pikën 3 thotë se Gjykata Themelore e Prishtinës është kompetente për të gjitha çështjet ekonomike, përdërisa

gjkata e apelit me seli në Prishtinë është gjykata e shkallës së dytë e vlefshme për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Në këtë gjykatë shqyrtohen edhe çështjet ekonomike të apeluara nga gjykata themelore. Brengosës mbetet fakti që çështja e IPR nuk është përfshirë në kompetencat e gjykatës themelore të cilat janë të listuara me nenin 13 të këtij Ligji.

Përvoja e gjykatësve që do të shërbenin në Departamentin Ekonomik të Gjykatës Themelore mbetet mjaft i paqartë. Në kreun I, Neni 26 pika 2.2 parasheh që një gjyqtar duhet të këtë 6 vite përvojë pune në çështjet juridike duke përfshirë këtu edhe çështjet ekonomike dhe administrative. Kjo duket një standard mjaft i ulët për një gjykatës i cili do të mund të vendoste për çështje shumë specifike të cilat janë përmendur më lartë.

Policia (njësiti për krime ekonomike)

Njësiti për krime ekonomike është themeluar në vitin 2009 dhe sipas udhëheqësit të tij, z. Agron Nezaj, njësiti ka pesë anëtarë dhe kapaciteti i kësaj zyre është ngritur gradualisht deri në masën 80%. Edhe pse nuk kanë ndonjë intervenim të deritanishëm në fushën e IPR, takime të ndryshme janë organizuar nga ZPI-ja në të cilat kanë marrë pjesë zyrtarë të këtij njësiti. Edhe pse njësiti është i limituar në numër, puna e tij në sfera tjera të krimeve ekonomike ka qenë mbresëlënëse (27.9 milion Euro është vlera e përgjithshme e pasurisë së ndaluar).



Duke pasur parasysh kohën e shkurtër të themelimit të këtij njësi, të dhënat e lartpërmendura janë mjaft premtuese. Mundësia e intervenimit të policisë në fushën e IPR është e kushtëzuar nga kodi penal i Republikës së Kosovës, i cili i mundëson ndërhyrjen e autoriteteve kompetente në këtë rast Policia e Kosovës, ndaj Cenimit të Drejtës së Patentës dhe Përdorimit të Paautorizuar të Firmës, Markës apo Modelit të Huaj (Neni 240 dhe 241 i Kodit Penal të Kosovës). Por një vërehet një ngecje në zbatimin e ligjit në këtë aspekt dhe këtë më së miri e shpjegon prania e mallrave të falsifikuara dhe dyqaneve që shesin materiale audio-vizuale pirateri anembanë Kosovës.

Problem tjetër i identifikuar gjatë intervistës me z. Nezaj, janë edhe pagat e punonjësve të këtij njësi si dhe shkalla e rrezikshmërisë me të cilën ata kategorizohen. Meqenëse punonjësit e këtij njësi përballen me rrezikshmëri më të lartë se punonjës të tjerë (p.sh. në pika doganore). Meqenëse policia bën sekuestrimin dhe jo konfiskimin e pasurive të paligjshme bazuar në hetimet e kryera apo me urdhër të prokurorisë, nuk janë caktuar procedurat e sekuestrimit. Duhet të merren parasysh procedurat e konfiskimit të mallrave për të gjitha rastet, rrjedhimisht edhe atyre që shkelin të drejtat e IPR. Duhet të përcaktohen mënyra e konfiskimit, prezenca e përfaqësuesve ligjor të palës pretenduese të këtyre mallrave, regjistrimin e tyre në vend, transportin adekuat si dhe magazinimin apo

¹¹ Policia e Kosovës

ruajtjen e tyre në vende që nuk dëmtohen mallrat e sekuestruara, deri në kohën kur gjykata vendos për fatin e tyre.

Pos tjerash, vërehet një vullnet i mirë dhe bashkëpunim i mirë mes punonjësve të këtij njësitit dhe përfaqësuesve të ZPI-së. Në mes tjerash, propozohet plotësimi i “20%” të mbetur me punonjës të trajnuar në fushën e IPR të cilët me lehtësi do të mund të merrnin përgjegjësitë e reja që do të bien mbi këtë njësit në mbrojtjen e drejtave të pronësisë intelektuale dhe luftimin e piraterisë dhe mallrave të falsifikuara.

Sektori i TIK-ut në Kosovë


Kërkesat e sektorit të TIK (Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit) në Kosovë, janë të ndryshme dhe në disa pika kontradiktore, sidomos kur ka të bëjë me çështjen e blerjes së licencave të softuerëve të ndryshëm nga ana e institucioneve publike. Gjithsesi, kjo është e kuptueshme duke pasur parasysh që STIKK ka një mori të ndryshëm anëtarësh që përfaqësojnë interesa të ndryshëm. Shoqata FLOSK¹² që përfaqëson interesat e open source softuerëve apo softuerët me kod të hapur (këtu e tutje të referohet si OSS), që me ngulm kundërshton blerjen e licencave nga institucionet publike të Republikës së Kosovës nga Microsoft apo të tjera kompani që kanë kodin e mbyllur, shumë prej të cilave janë të përfaqësuara nga distributorë të autorizuar në Kosovë (Cactus, Expik). Kërkesa e kësaj shoqate është që duke u dhënë mundësi softuerëve tjerë si LINUX që janë licence-free kursehet një sasi e konsiderueshme e parasë publike. Në fakt, ka një trend në qeveritë e BE-së që të inkurajohet përdormi i OSS softuerëve në institucionet publike dhe në e-qeverisje. Në Britaninë e Madhe, njësitit i e-Qeverisjes (i qeverisë Britanike) ka miratuar disa politika që i bëjnë thirrje institucioneve publike dhe qeverisë në Britani të Madhe të marrin parasysh solucionet e OSS-ve në proporcion me ato që janë me kod të mbyllur kur bëhej fjalë për IT prokurimet. Madje këto politika bëjnë thirrje për përdorimin e solucioneve OSS në të ardhmen.¹³ Justifikimet për përdorimin e OSS-ve sipas këtij raporti janë mjaft mbresëlënëse dhe ndihmojnë në kursimin e parasë publike si dhe në financimin e R&D-ve. Megjithëse kjo

¹² Anëtare e STIKK-ut

¹³ “OPEN SOURCE SOFTWARE -Use within UK Government” 2004- E Government Unit –faqe 5

është çështje tjetër dhe rregullohet me ligjet e konkurrencës së lirë por edhe me politika tjera të posaçme të cilat mbështesin këtë doktrinë. Sidoqoftë, këto çështje tjera të cilat nuk hyjnë në kuadër të ligjeve të IPR.

Kërkesa tjera që vijnë nga ky sektor (sidomos nga ata që merren me zhvillimin e softuerëve) është që institucioni përkatës që në këtë rast është Ministria e Kulturës, Zyra për të drejtat e autorit të merret me menaxhimin dhe regjistrimin e softuerëve që zhvillohen nga këto kompani në mënyrë që në rast kontesti të merret ajo me zgjedhjen e tyre. Kjo në fakt është gati e pamundur për shkak së Zyra për të Drejtat e Autorit nuk është gjykatë dhe nuk bën pranimin e dëshmime mbi pronësinë e një veprë të krijuar qoftë kjo softuer, libër, film apo krijimtari tjetër që mund të mbrohet nga ligji. Ligji aktual i të drejtës së autorit nuk flet mbi çështjen e menaxhimit të drejtës së autorit. Por sipas informatave që kemi nga pjesëmarrësit në grupet punuese brenda ministrisë për ndryshimin e ri, ligji i amandamentuar parasheh licencimin e shoqërive për menaxhim kolektiv të drejtave të një kategorie krijimtarie (p.sh. shoqata e kompozitorëve merret me menaxhimin e gjithë kompozitorëve që veprojnë brenda kësaj shoqate). Në çështjen se kush do të merret me menaxhimin kolektiv të të drejtave të autorit për zhvilluesit e softuerëve mbetet të caktohet pas miratimit të ligjit të ri në parlament (parashihet në Shtator 2011). Tek kompanitë e mëdha siç janë Expic, Rrota dhe Cactus vërehet një njohuri më e madhe lidhur me të drejtat e autorit dhe shumica prej tyre kanë pasur pak a shumë të njëjtin problem. Shumë prej këtyre kompanive kanë punësuar persona të cilët gjatë punës së tyre kanë pasur



qasje në kodet softuerike të kompanive në fjalë por që i kanë marrë këto kode dhe i kanë përdorur edhe pas largimit nga këto kompani. Shumë prej tyre janë të brengosur se deri ku i

mbrojnë ligji ato si kompani dhe si duhet vepruar në këto raste. Në shumicën e rasteve çështjet janë mbyllur me negociata dhe nuk kanë arritur në gjykatë por shqetësimi ekziston rreth gjykatave kompetente për gjykimin e këtyre çështjeve. Megjithatë, përpos kohës që mund të konsumojnë proceset gjyqësore shqetësim tjetër mund të paraqet edhe specifika e lëndës së kontestuar, dhe vendimi i një gjykate mbi çështje që janë të një natyre teknike. Kush do të ishte kompetent për këto çështje apo thënë shkurt tek kush do të drejtohej në gjykatë për opinion për çështje të tilla?

Në përgjithësi kompanitë e intervistuar kanë shprehur interesim për të drejtat intelektuale.

Rekomandimet

Në mënyrë që mbrojtja e pronës intelektuale të jetë një mision i suksesshëm për vendin dhe komunitetin, qeveria duhet të konsiderojë marrjen e masave në këto pika:

- Ofrimi dhe zbatimi i rreptë i të drejtave të pronës intelektuale për të gjithë (vendas apo të huaj).
- Përmirësimi i qasjes në sistemet vendore dhe ndërkombëtare të pronësisë intelektuale duke mbajtur të ulët koston e përfitimit, mirëmbajtjes dhe zbatimit të këtyre të drejtave.
- Harmonizimi i legjislacionit mbi pronën intelektuale me Bashkimin Evropian dhe atë ndërkombëtar.
- Bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare përkatëse në mënyrë që të ulët kostoja për persona që dëshirojnë t'i shtrijnë të drejtat e tyre në vende tjera përmes Kosovës.
- Të sigurohet që institucionet që merren me pronësinë intelektuale të janë efikase dhe të mirë financuara.
- Të mbështeten politikat e pronësisë intelektuale me një menaxhim dhe infrastrukturë të mirë në fusha si: edukimi, shkenca, teknologjia, kultura, tatimet,

politikat mbi investimet, iniciativat prodhuese dhe teknologjike, tregtia dhe konkurrenca.

- Edukimi i komuniteteve lokale, bizneseve dhe publikut lidhur me benefitet potenciale që vijnë nga sistemi i mbrojtjes së pronësisë intelektuale.
- Ofrimi i mbështetjes për shpikësit/prodhuesit/ se si të përdorin mbrojtjen e pronësisë intelektuale në dobi të tyre si dhe mbështetja e grupeve të interesit në këtë fushë.
- Afrimi dhe krijimi i urave në mes institucioneve akademike (universitete, fakultete ,etj.), instituteve hulumtuese dhe bizneseve apo institucioneve tjera financiare që do të mund të financonin projekte në fusha të ndryshme të teknologjisë, bioteknologjisë, teknikës, medicinës, etj.
- Marrja e masave ndaj produkteve dhe shërbimeve të falsifikuara dhe piraterisë; kjo mund të arrihet nëse bëhet prioritet krijimi i një kornize ligjore që siguron implementim efektiv të masave ndaj keqpërdorimit apo vjedhjes së të drejtave të pronës intelektuale.
- Të ndryshohet aplikacioni për patentë, përkatësisht mundësia që ofrohet për të mos cekur emrin e shpikësit. Mundësia për të lënë shpikësin anonim bie ndesh me Ligjin për Patenta (pika 12.3).
- Të plotësohen pozitat në institucionet përkatëse me kandidatë me përgatitje akademike nga fusha e IPR. (Ka një sërë studentësh që kanë mbaruar studimet postdiplomike në vende të ndryshme të BE-së në kuadër të programit të përbashkët për bursa EU Commission –Qeveri e Kosovës “EU Scholarship scheme”)
- Të ndryshohet Ligji mbi Gjykatat 03/L-99, përkatësisht të futet kategoria e çështjeve ligjore të IPR si kompetencë e Gjykatës Themelore të Prishtinës (Departamenti i çështjeve ekonomike).
- Të zbatohet kodi civil i Kosovës, saktësisht Neni 240 dhe 241.
- Të ndryshohet Neni 26 i Ligjit mbi Gjykata, përkatësisht kualifikimet e gjyqtarëve për çështje ekonomike (për ata gjyqtarë që do të gjykojnë mbi çështje të pronësisë intelektuale). Të merren kriteret për kualifikim nga ndonjë vend anëtar i BE-së.

- Të caktohet një grup brenda Ministrisë së Tregtisë i cili do të merrte përsipër negociatat për aderim të Kosovës në WTO, EPO, WIPO.
- Përgatitja e ligjit për Indikatorët Gjeografikë, si dhe identifikimi i produkteve vendore që kanë potencial për mbrojtje.

Propozimi për themelimin e një këshilli nacional kundër falsifikimit vazhdim është më kompleks prandaj është paraqitur në detaje.

Krijimi i këshillit nacional kundër falsifikimit

Ky këshill do të mundësonte dhe lehtësonte komunikimin në mes grupeve të interesit të cilat janë përgjegjëse me ligj për implementimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Ky këshill do të ishte një bashkëpunim i drejtpërdrejtë në mes institucioneve publike dhe organizatave të interesit social dhe ekonomik për të ngritur efektshmërinë në luftën kundër falsifikimit. Anëtarë të këshillit do të mund të ishin përfaqësues të institucioneve publike që janë të implikuar në një mënyrë apo tjetër me të drejtat e pronësisë intelektuale. (P.sh. ministritë kompetente, institucionet e zbatimit të ligjit etj.)

Përgjegjësitë e këshillit nacional kundër falsifikimit do të mund të ishin këto:

- Përpilimi i një strategjie nacionale dhe një plani të veprimit kundër falsifikimit i cili do të harmonizonte veprimet kundër falsifikimit;
- Të iniciojë dhe udhëheqë një kampanjë vetëdijesimi lidhur me mbrojtjen e pronësisë intelektuale;
- Të organizojë programe trajnimi për autoritetet kompetente në fushën e anti-falsifikimit;
- Të delegojë propozime tek ministritë kompetente për elaborimin e ligjeve për të mundësuar një mbështetje sa më efektive në zbatimin e IPR.